


## *Bilanci Kombetar i Energjise 2017*



Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore



**Tirane 2018**

## PERMBAJTJE

1.	<b>HYRJE</b> .....	4
1.1	Sfidat e sektorit te energjise.....	5
1.2	AKBN - Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore: .....	6
1.3	Bilanci energjetik .....	7
2.	<b>PRODUKTET PRIMARE</b> .....	8
2.1	Nafta dhe Gazi.....	8
2.2	Qymyri .....	9
2.3	Energjia Elektrike.....	9
2.4	Importi i energjise elektrike .....	11
3.	<b>BURIMET E RINOVUESHME</b> .....	11
3.1	Drute e Zjarrit .....	11
3.2	Hydroenergjia .....	11
3.3	Biokarburantet.....	12
3.4	Energjia Diellore .....	12
3.5	Energjia e eres.....	12
4.	<b>TRANSFORMIMI</b> .....	12
4.1	Energjia Hidrike .....	12
4.2	Rafinerite.....	13
5.	<b>KONSUMI</b> .....	13
5.1	Sektori i industrise.....	13
5.2	Sektori i transportit.....	13
5.3	Sektori i banesave.....	14
5.4	Sektori i sherbimeve.....	14
5.5	Sektori i bujqesise .....	14

## 1. HYRJE

Pergatitja e bilancit te energjise per vitin 2017 ka ndodhur gjate nje periudhe zhvillimesh dinamike ne sektorin energjetik te Shqiperise. Gjate kesaj periudhe u hartuan dhe u miratuan nje numer ligjesh dhe rregulloresh. Sektori i energjise elektrike po kalon reforma te rendesishme strukturore, ligjore, tarifore. Edhe sektori i naftes dhe gazit eshte objekt i zhvillimeve te rendesishme.

Gjithashtu, gjate kesaj periudhe, Shqiperia ka vazhduar te zbatoje detyrimet dhe angazhimet e saj drejt integritimit rajonal permes Komunitetit te Energjise dhe ka marre angazhime dhe nisma te reja nderkombetare, perfshire edhe ato ne lidhje me veprimet klimatike. Te gjitha keto aktivitetet kane sherbyer si baze per ndertimin e Bilancit te Energjise.

Bilanci i Energjise paraqet nje sinteze te analizes se detajuar te te dhenave ne sektorin e energjise dhe dokumenteve te tjera strategjike, plane sektoriale dhe ndersektoriale, shumica e te cilave jane perfshire ne nje rishikim analitik te rrugeve te ardhshme te zhvillimit per sektorin energjetik te Shqiperise. Shume nga te dhenat dhe dokumentat kyçe, te permendura ne kete Bilanc, kane qene ende ne shqyrtim gjate kesaj periudhe.

Si nje proces kompleks dhe shume dimensional, Bilanci i energjise eshte ndertuar nga nje grup pune i cili ka punuar ngushte ne marrjen e informacionit ne institucionet pergjegjese te energjise si: Ministria e Infrastruktures dhe Energjise, ERE, kompanite e energjise elektrike (KESH, OST dhe OSHEE) dhe kompanite e naftes dhe gazit si ALBPETROL, ARMO, ALBGAS. Ky grup pune ka koordinuar procesin e hartimit te Bilancit te Energjise dhe eshte mbeshtetur nga INSTAT me ekspertize teknike. Grupi i punes se Bilancit te Energjise, eshte i perbere nga eksperte kryesore ne fushat e energjise elektrike, naftes dhe gazit, burimeve te ripertesishme, eficences se energjise dhe planifikimit strategjik te energjise.

Analiza e Bilancit te Energjise u krye duke perdorur modelin e EUROSTAT, nje model bilanci i provuar dhe i perdorur me pare nga Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore dhe qe perdoret nga te gjitha vendet e Europes Juglindore. Rezultatet analitike ofruan matrica sasiore per vleresimin e rezultateve te mundshme te Bilancit ne sherbim te plotesimit te pyetesoreve analitik te energjise.

Vleresimi i te dhenave te bilancit eshte zhvilluar ne konsultim me ekspertet e institucioneve te ndryshme te energjise bazuar ne te dhenat progresive ne Sektoret e Energjise Elektrike, Naftes dhe Gazit Natyror, BRE dhe PEN.

Bilanci Kombetar i Energjise eshte nje dokument shumedimensional me nje horizont informacioni qe perfshin nje numer te konsiderueshem sektoresh dhe nen-sektoresh, politikash dhe rezultatesh. Ai synon te identifikojë dhe te paraqese informacionet baze te energjise te cilat do te sherbejne per zbatimin e politikave, objektive dhe rezultateve qe identifikojne zhvillimin energjetik te vendit tone. Duke pasur parasysh pasigurite e qenesishme ne informacionet energjetike, te cilat jane kompensuar me te dhena statistikore jane perdorur modelet e llogaritjes nga poshte-lart ne parametrat specifike sektorial te energjise. Per kete qellim, synohet qe instrumentet regullues te

propozuara te mos kene ndikim ose te kene ndikim minimal ne qasjen e informacionit te Bilancit dhe ne pajtim me rregullat e BE-se per statistikat e energjise.

## 1.1 Sfidat e sektorit te energjise

Qe prej vitit 1992, ekonomia shqiptare ka perjetuar nje transformim nga nje ekonomi e centralizuar ne nje ekonomi tregu. Vlera e PBB-se per fryme, gjate dy dekadave te fundit, eshte rritur per shkak te nje numri faktoresh, duke perfshire nje program ambicioz per zhvillimin ekonomik, mbeshtetjen e zhvillimit te ofruar nga donatoret dhe nje pozicion te favorshem gjeografik si nje ure qe lidh Ballkanin me Evropën Perendimore. Sfidat me te cilat ballafaqohet aktualisht sektori shqiptar i energjise jane:

- Permbushja e zhvillimeve ekonomike ne sektore te ndryshem dhe niveli ne rritje i konsumit te energjise per fryme;
- Permiresimi i trendit te intensitetit te energjise;
- Rritja e sigurise se furnizimit te energjise duke permiresuar eficiencen e energjise, rritjen e pjeses se burimeve te ripërteritshme te energjise dhe burimeve te tjera konvencionale te energjise, dhe rritjen e bashkepunimit dhe integritimit rajonal.

Historikisht, ne Shqiperi konsumi i energjise per fryme ka qene shume i ulet, gje qe tregon nivele te uleta te aktivitetit ekonomik, si dhe nivele modeste te komfortit ne sektoret e ekonomise, banesave dhe ate te sherbimeve. Nga ana tjetër, intensiteti i energjise, tregues qe tregon raportin e furnizimit primar te energjise ne nje vit te caktuar kundrejt PBB-se te te njejt vit, ka qene shume i larte. Arsyet jane te njejta, si per vendet e tjera te Evropës Qendrore, ashtu dhe Evropës Lindore: industria shqiptare ka qene e orientuar drejt industrive me intensitet te larte energjitik, sic jane minierat dhe metalurgjia, ku çmimet e energjise jane mbajtur ne nivele relativisht te uleta. Keshtu, nje nga sfidat me te rendesishme te Shqiperise eshte rritja e konsumit relativisht te ulet te energjise per fryme, nderkohe qe reduktohet niveli i larte i intensitetit te energjise ne menyre qe te kete nje ekonomi efikase e cila do te konkurroje ne tregjet e brendshme dhe te jashtme.

Sfidat lidhur me sigurine e energjise perfshin nder te tjera dhe permbushjen e kerkeses ne vend per nafte bruto prodhimi i te ciles eshte ne renie. Kerkesa totale e burimeve primare te energjise nuk mund te permbushet me burimet e brendshme te energjise. Ato kane rene vazhdimisht gjate periudhes 2001-2017, me vete-mjaftueshmerine e burimeve primare te energjise duke u ulur nga 97% ne vitin 1990 ne rreth 41,2% ne vitin 2017. Pra, eshte e qarte qe plotesimi i kerkeses energjetike te vendit kerkon zhvillim te metejshe me burimeve te brendshme, si dhe liberalizimin dhe integrimin ne tregun rajonal.

Pervec sfidave te mesiperme, tri sfida te tjera per sistemin energjetik shqiptar jane: arritja e objektivit te BRE-se ne vitin 2020 dhe me tej, arritja e objektivit te EE-se per reduktimin e perdorimit final te energjise dhe arritja e objektivit te KKP-se per reduktimin e emetimeve te GHG-se. Keto sfida te sektorit te energjise jane llogaritur bazuar ne vleresimet e treguesve te ardhshem

ekonomike dhe energjetike me nje nivel te percaktuar pasigurie, mungesa te nje infrastrukture te pershtatshme dhe efektive per mbledhjen e te dhenave si dhe mungese te strategjive zhvillimore ne disa sektore.

Sfida perfundimtare eshte menaxhimi i tranzicionit ne modelin e ri te tregut, duke perfshire mbrojtjen e konsumatoreve (familjare) me nivel te ulet te te ardhurave.

## **1.2 AKBN - Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore**

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN) i raporton Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise (MIE) per zhvillimin, mbikeqyrjen e perdorimit racional te burimeve natyrore sipas politikave se qeverise dhe monitorimin e post-shfrytezimit te minierave, naftes dhe energjise.

- Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore ka nje sere pergjegjesish ne fushen e energjise te tilla si:
- propozimi, konsultimi dhe bashkepunimi me strukturat perkatese te qeverise per hartimin e politikave dhe strategjive ne fushen e minierave, hidrokarbureve dhe energjise;
- zbatimi i politikave qeveritare ne fushen e minierave, hidrokarbureve dhe energjise;
- hartimi dhe publikimi i bilancit vjetor te energjise, ne nivel kombetar dhe rajonal, ne perputhje me formatet e Eurostat dhe Agjencise Nderkombetare te Energjise;
- propozimi i masave per rritjen e perdorimit te energjise ne ciklin e energjise;

Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore prej vitit 2011 nderton Bilancin Kombetar te Energjise ne bashkepunim me:

- EUROSTAT (Institucioni i Statistikave te Bashkimit Europian), European Commission – Eurostat, Unit E.5: Energy, 2920 Luxembourg.
- IEA (Agjencine Ndekombetare te Energjise), (31-35, rue de la Fédération, 75739, Paris, Cedex 15, France).
- UNSD, (Institucionin e Statistikave te Kombeve te Bashkuar), United Nations Statistics Division, Energy Statistics Section 2 UN plaza, DC2-1414, New York, NY 10017, USA.

AKBN bashkepunon me INSTAT duke i pergatitur te gjitha te dhenat ne fushen e energjise dhe te dy institucionet se bashku kete informacion e raportojne ne EUROSTAT duke ndjekur procedurat e EDAMIS (Sistemi Elektronik i Administrimit te te Dhenave dhe Menaxhimit te Informacionit <https://webgate.ec.europa.eu/edamis/>).

AKBN eshte pjese e grupit te punes ne “ENERGY COMMUNITY” (Komunititn e Energjise ne Vjene) per raportimin e stistikave te energjise per Shqiperine duke marre pjese regullisht ne

takimet qe organizon ky institucion per statistikat e vendeve te Europes Juglindore dhe te ish vendeve te Bashkimit Sovjektiv.

AKBN-ja qe prej vitit 2015 eshte pjese e organizates JODI (Iniciativa e Perbashket e Organizimit te Dhenave [www.jodidata.org](http://www.jodidata.org)) institucion qe bashkepunon ngushte me 6 organizata (APEC, Eurostat, IEA, OLADE, OPEC and UNSD) ku ne dergojme regullisht te dhenat mujore te prodhimit te naftes, gazit dhe te bilancit te rafinerive te Shqiperise.

AKBN-ja, ne bashkepunim me EUROSTAT dhe IEA ne nderton bilancin kombetar te energjise duke permblodhur te dhenat ne 5 pyetesore (te naftes, gazit, qymyrit, energjise elektrike dhe burimeve te rinovueshme). Pergatitja e ketyre pyetesoreve ka per qellim te thjeshtesoje paraqitjen e te dhenave si dhe per te minimizuar riskun e te dhenave te gabuara.

AKBN-ja hedh te dhenat ne programin SHARES (**SH**ort **A**ssessment of **R**enewable **E**nergy **S**ources) i cili ka si qellim te thjeshtesoje llogaritjen kontributit te Burimeve te Rinovueshme bazuar ne direktiven 2009/28/EC. Kjo metodike eshte e unifikuar per te gjitha vendet e BE-se dhe te Europes Jug-Lindore. Zbatimi i saj parandalon çdo parregullsi te parametrave dhe rregulla te ndryshme te perdorura ne metoda te ndryshme llogaritese si dhe siguron rezultate te harmonizuara dhe te krahasueshme per te gjitha vendet raportuese. Per kete arsye, metoda SHARES konsiderohet te jete nje qasje me efikase ne vleresimet/llogaritjet individuale te kryera nga çdo shtet anetar i BE.

### 1.3 Bilanci energjetik

Bilanci energjetik, tregon ne menyre te sintetizuar, furnizimin e vendit tone me burime energjetike, te cilat jane te domosdoshme per nje zhvillim te qendrueshem te ekonomise se vendit. Gjithashtu, ai paraqet lendet energjetike ne transformimin e tyre, duke nxjerre ne menyre indirekte problematiken lidhur me teknologjite qe sherbejne ne perpunimin e tyre. Pjesa qe paraqet konsumin ne bilanc paraqet se cilat lende energjetike dominojne tregun, si shpendahen ato, cilat jane problemet e konsumit dhe si duhet te merren masat per uljen e tij.

Bilancit energjetik per vitin 2017 prezanton problemet dhe sfidat e mprehta energjetike me te cilat ballafaqohet vendi yne. Ende ne informacinet qe ndihmojne ne pergatitjen e bilancit energjetik ka probleme ne sigurimin e te dhenave, sidomos nga sektori privat te cilat sigurohen me mjaft veshtiresi. Keto problematika duhet te gjejne zgjidhje nepermjet permiresimit te kuadrit ligjor, i cili duhet te detyroje institucionet publike dhe private te raportojne bilancet energjetike duke perfshire ketu dhe aktivitetet industriale. Ne bashkite e vendit tone vazhdon akoma te kete probleme ne ndertimin e nje data-baze per grumbullimin e te gjitha informacionit ne territorin ku ato ushtrojne aktivitetin.



Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore ne mbledhjen e te dhenave energjetike ka bashkepunuar ngushte me INSTAT-in, Ministrine e Energjise dhe Industrise (MEI), Entin Regullator te Energjise (ERE), Drejtorine e Pergjithshme te Doganave, Inspektoriatin Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI), Operatorin e Shperndarjes se Energjise Elektrike (OSHEE), Korporata Energjetike Shqiptare (KESH), Operatori i Sistemit te Transmetimit (OST) si dhe Kompania ARMO.


## 2. PRODUKTET PRIMARE

Furnizimi me energji primare ne Shqiperi dominohet nga nafta, prodhimi i energjise elektrike nga hidrocentralet si dhe biomasa, te cilat jane te pa mjaftueshme per realizimin e kerkeses totale per energji. Diferencat plotesohet nepermjet importit, vecanerisht per nenproduktet e naftes dhe energjise elektrike.

### 2.1 Nafta dhe Gazi

*Prodhimi ne vend i naftes* per vitin 2017 ka qene 958,935.9 ton duka patur nje ulje te lehet krahasuar me vitin 2016 prej 9% si pasoje e renies natyrale. Ne vitin 2017 nafta brut nga marreveshjet hidrokarbure ishte 861,683.5 ton, ku shitjet brenda vendit kane qene 312,708.6 ton dhe eksportet 471,025.1 ton.

Albperoli per vitin 2017 ka patur nje prodhim te naftes bruto 93,086.4 ton nga keto 27,572.0 ton kane prodhuar vendburimet ranore dhe 65,514.0 ton vendburimet gelqerore. Shtjet e naftes brut ne tregun vendas per vitin 2017 per Albperolin ishin 211,263.0 ton.



**Figura 1:** *Ecuria e Prodhimit dhe Importit te produkteve te naftes (ktoe)*

**Prodhimi i gazit** ne vendin tone ka qene ne total gaz shoqerues i naftes, rreth 102.24 milion Nm<sup>3</sup>, sasi gati e paperfillshme dhe qe sherben vetem per proceset teknologjike te industrise se naftes. Pavaresisht nga angazhimet e strukturave te shtetit dhe nxitjes se investitoreve te huaj, vendi yne nuk eshte lidhur me rrjetin nderkombetar te gazit. Eshte e kuptueshme se lidhja e Shqiperise me rrjetin e gazit do te kete nje ndikim pozitiv ne permiresimin e situates energjetike ne vend, duke ndikuar ne menyre te ndjeshme ne raportet e perdorimit te energjive ku deri me sot ngarkesa kryesore i takon nenprodukteve te naftes dhe energjise elektrike.

**Importi i produkteve** te naftes dhe i naftes bruto per vitin 2017 arrin vleren 1229.27 ktoe me nje ulje 69 ktoe krahasuar me vitin 2016. Gazoili, benzina dhe gazi i lengeshem i naftes dominojne ne importin e produkteve te naftes

**Eksporti i naftes** dhe i nenprodukteve te saj per vitin 2017 per naften brut ishte 471 ktoe dhe i nenprodukteve te naftes 155.56 ktoe. Kjo ulje e eksportit te naftes brut ka ardhur si pasoje nderprerjes se operimit te rafinerise se Ballshit gjate vitit 2017.

## 2.2 Qymyri

Per vitin 2017 prodhimi i zhavorit bituminoz ka qene 45.8 ktoe si dhe importi i qymyrit ka qene 74.80 ktoe. Te dyja keto lende karahasur me vitin 2016 kane pesuar nje ritje si pasoje e perdorimit te tyre nga industria e cimentos dhe e tullave te cilat per vitin 2017 kane punuar me kapacitet te plote.

## 2.3 Energjia Elektrike

Prodhimi publik i energjise elektrike kryhet nga shoqeria aksionere KESH sh.a. me 100% te aksioneve shteterore. Perberja e grupit te centraleve te zoteruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, te cilet realizojne prodhimin publik eshte paraqitur ne tabele. Fuqia e pergjithshme e instaluar arrin ne 1,448 MW, nga te cilat fuqia e instaluar e HEC-ve eshte 1,350 MW dhe e TEC Vlore 98 MW.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HEC Fierze	HEC Koman	HEC V.Dejes	TEC Vlore
<b>Nr. Agregateve.</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>5</b>	<b>2</b>
<b>Fuqia e Agregateve (MW)</b>	<b>125</b>	<b>150</b>	<b>50</b>	<b>70+28</b>
<b>Fuqia Instaluar e centralit (MW)</b>	<b>500</b>	<b>600</b>	<b>250</b>	<b>98</b>
<b>Fuqia Totale (MW)</b>	<b>1 448</b>			

**Tabela 1.** *Struktura e Centraleve Elektrike te Prodhimit Publik*



Duke marre parasysh edhe fuqine e pergjithshme te instaluar te prodhuesve privat/koncesionar te energjise elektrike prej 697 MW rezulton qe fuqia e pergjithshme e instaluar (e licensuar) ne vendin tone te jete 2,145 MW.

I gjithe prodhimi neto publik i energjise elektrike ne vitin 2017 ishte 4,525,173 MWh i realizuar 100% nga hidrocentralet (HEC-et):

**2,916,989** MWh nga centralet prodhuese hidro të KESH sh.a (prodhimi publik)

**1,608,184** MWh nga centralet prodhuese hidro të tjerë.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2017 është rreth **1,917 MW** dhe prodhimi neto i tyre është **4,051,512 MWh**.

#### *Prodhimi i energjise elektrike nga TEC-i i Vlores*

Gjate vitit 2017 nuk eshte prodhuar energji elektrike nga TEC Vlora, por jane realizuar sherbimet e mirembajtjes profilaktike dhe mirembajtjes se programuar te impiantit, sipas nje grafiku vjetor.

Ky TEC ishte parashikuar te vihej ne pune gjate vitit 2011, por per shkak te defektit ne sistemin e ftohjes ne TEC Vlora ende nuk eshte mundesuar venia ne pune. KESH sh.a. dhe kontraktori i ndertimit te TEC-it jane ne proces arbitrazhi (gjyqesor) per zgjidhjen e kundershive.

#### *Prodhimi nga HEC-et private/koncesion te energjise elektrike dhe PV*

Prodhimi i pergjithshem neto per vitin 2017 nga gjeneruesit private/koncesion ishte 1,608,181 MWh ose rreth 35.5 % e prodhimit te pergjithshem vendas prej 4,525,173 MWh.

Nje central Fotovoltaik i UKKO sh.a. me kapacitet rreth 1 MW ka prodhuar per nevojat e saj dhe ka pasur marreveshje “netmetering” me OSHEE sh.a. nepermjet se ciles rakordohet sasia e prodhuar dhe sasia e konsumuar. Prodhimi i ketij centrali nuk eshte perfshire ne bilancin energjetik te OSHEE sh.a.

Rezultatet e marrveshjes UKKO-OSHEE (per prodhimin fotovoltaik)					MWh	
UKKO	2014	2015	2016	2017	2018	
Prodhuar ( kwh)	528	1,397	1,362	1,222	137	
Kompesuar (kwh)	-	1,581	1,177	630	137	
Diferenca ( kwh)	528	(184)	185	592	-	

## **2.4 Importi i energjise elektrike**

Per vitin 2017 bilanci i shkembimeve te energjise elektrike ka qene negativ me nje import prej 2915 GWh si rezultat i prurjeve te dobta te lumenjeve qe furnizojne hidrocentralet tona.

## **3. BURIMET E RINOVUESHME**

Per vitin 2017 burimet e rinovueshme kane patur nje kontribut prej 27.6% me nje ulje rreth 5 % krahasuar me vitin 2016 si pasoj e sasise se reshjeve te ulta qe pati ky vit. Energja hidrike vazhdon te dominoje ne burimet e rinovueshme ndersa burimet e tjera te rinovueshme me perjashtim te biomases (drute e zjarrit) dhe biokarburanteve, kane nje rol te moderuar ne kontributin e tyre. Energjia diellore kryesisht perdoret per prodhimin e ujit te ngrohje ndersa burimet e tjera jane ne fazen e investigimit te tyre.

Ligji 7/2017 “Per nxitjen e Burimeve te Rinovueshme te Energjise” i miratuar ne 2 Shkurt 2017 i harmonizuar me ligjin 43/2015 per Sektorin e Energjise Elektrike reflekton ne menyre te plote mundesine e hyrjes ne tregun e liberalizuar te energjise elektrike te gjeneratoreve nga burime te rinovueshme duke hapur nje mundesi te mire per zhvillimin e tyre.

### **3.1 Drute e Zjarrit**

Drute e zjarrit jane nje burim i rendesishem energjie, te cilet kane dhene dhe vazhdojne te japin kontribut te ndjeshem ne bilancin energjetik shqiptar, ne plotesimin e nevojave per ngrohje, uje te ngrohje dhe gatim. Ne vitin 2017, rezulton qe 92% e druve te zjarrit jane konsumuar ne sektorin e banesave dhe vetem nje pjese e vogel ne sektorin e sherbimeve dhe te industrise. Krahasuar me periudhen e viteve te kaluara, vihet re qe struktura e konsumit te druve te zjarrit sipas sektoreve ka ruajtur te njejtin tipar, ate te perdorimit te tyre ne sektorin e banesave.

Vlen te permendim gjate vitit 2017 vendi yne ka importuar dru zjarri per konsum energjie si dhe per prodhimin e peletave. Aktualisht ne vendin tone ka 4 fabrika qe prodhojne peletat te cilat kryesisht i eksportojne dhe fare pak qendrojne te konsumatorit tane. Konsumi i druve te zjarrit edhe ne vitin 2017 eshte 168 Ktoe(i llogaritur) me nje ulje, 20 ktoe karahasuar me vitin 2016.

### **3.2 Hidroenergja**

Hidroenergja eshte burimi me i madh i energjive te rinovueshme ne vendin tone. Shqiperia renditet ne Europe si nje vend me pasuri ujore te konsiderueshme, me nje shtrirje hidrografike te shperndare pothuajse ne te gjithë territorin.

Shqiperia, me siperfaqen e saj prej 28 748 km<sup>2</sup>, ka nje shperndarje hidrografike me nje siperfaqe ujembledhese prej rreth 44,000 km<sup>2</sup> ose 57% me shume se gjithë territori shteteror. Nga pikpamja

topografike, duke qene nje vend me relief relativisht te thyer, vendi yne ka nje rezerve hidroenergetike te madhe me kapacitet 35 Twh.

### **3.3 Biokarburantet**

Biokarburantet te mbeshtetura ne ligjin nr. 9876/2008 *“Per prodhimin, transportimin dhe tregtimin e bio-karburanteve dhe te lendeve te para djegese, te rinovueshme, per transport”* vazhdojne te risin kontributin e tyre ne konsumin final te energjise per vitin 2017. Sasia e perzier me biodiezel ka qene 87.87 ktoe.

### **3.4 Energjia Diellore**

Ne Shqiperi rrezatimi diellor vjetor eshte i larte dhe teorikisht mund te sigurojne nje ngrohje te nevojshme me temperature te ulet gjate gjysmes se vitit. Gjithsesi panelet diellore te disponueshem ne tregjet shqiptare pjeserisht ndihmohen nga energjia elektrike, vecanerisht gjate periudhes nentor-mars. Ne kete kuader Shqiperia ka bere gjithashtu progres te dukshem ku sipas vleresimeve siperfaqja kumulative e sistemeve te prodhimit te ujit te ngrohje nga rrezatimi diellor eshte 23,5m<sup>2</sup>/1000 banore. Per vitin 2017 energjia diellore e konsumuar per uje te ngrohje eshte 13.2 ktoe.

Ne Shqiperi i vetmi impiant fotovoltaik me fuqi te instaluar rreth 1 MW, qe aktualisht eshte ne operim, vjen nga Shoqeria “UKKO”sh.a. Korce. Me statusin e “vete prodhuesit” kjo kompani ka filluar prodhimin e energjise elektrike per nevojat e veta. Statusi i vete prodhuesit parashikon shkembimin e energjise elektrike me rrjetin e shperndarjes dhe bilancin e prodhimit vjetor te energjise nga impianti fotovoltaik me pak se nevojat vjetore te kompanise. Ne kete kuptim “UKKO”sh.a. Korce nuk eshte prodhues i energjise elektrike por konsumator i saj.

### **3.5 Energjia e eres**

Shfrytezimi i energjise se eres ne vendin tone nuk ka filluar ende, por ka nje shprehje shume te madhe interesi nga investitoret e huaj. Ne kete kuader, jane ne studim disa rajone te vendit tone nga disa kompani te huaja te cilat synojne te ndertojne parqe eolike per prodhimin e energjise elektrike.

## **4. TRANSFORMIMI**

### **4.1 Energjia Hidrike**

Per vitin 2017 prodhimi i energjise elektrike nga Hidrocentralet arriti nje prodhim bruto ne vleren 389.15 ktoe dhe nje prodhim neto ne vleren 386.71 ktoe.

## **4.2 Rafinerite**

Per vitin 2017 rafinerite kane punuar ne menyre periodike, duke perpunuar rreth 533.18 ktoe ku 80% te saj e ka perpunuar rafineria e Ballshit me nje humbjet teknologjike 0.4%.

Sektori i rafinimit te naftes bruto vazhdon te perballet me veshtiresi serioze, si pasoje e problemeve ekonomike te shoqerise qe administron kete sektor. Vlen te theksojme se Rafinerite tona kane probleme serioze ne kontrollin e ndotjeve mjedisore, per shkak te mungeses se investimeve ne kete sektor pasi teknologjia e perdorur eshte e vjeter dhe e amortizuar.

## **5. KONSUMI**

### **5.1 Sektori i industrise**

Bilanci i energjise, sektorin i industrise e paraqet te ndare ne 10 nensektoret si me poshte: metalurgji, kimi, materiale ndertimi, miniera, ushqim/pije/duhan, tekstil/lekure/kepuce, dru/leter/stampim, mekanike dhe te tjera. Konsumi i energjise ne keta nensektore eshte perqendruar ne venjen ne pune te paisjeve motorike si dhe per procese teknologjike. Ne vendin tone konsumatore te larte te energjise ne keta nen sektore jane industria e materialeve te ndertimit si dhe industria metalurgjike.

Perqindja e konsumit final te energjise ne kete sektor ne vitin 2017 eshte 413.4 ktoe me nje ritje 97 ktoe krahasuar me vitin 2016. Kjo si pasoj e kontributit te larte te industrise se materialeve te ndertimit.

### **5.2 Sektori i transportit**

Nga te dhenat e sektorit te transportit ne Shqiperi shihen tendenca ne rritje te aktiviteteve te tij, ne drejtim te shperndarjes se peshes ne aktivitetet e tij qe synon t'i pergjigjet sfides globale per zbutjen e ndryshimeve klimatike. Vlen te theksojme qe sektori i transportit ne Shqiperi duhet te zbatoje masat te repta qe permiresojne ne menyre te konsiderueshme eficiencen e energjise si dhe per t'i hapur rrugen uljes se emetimeve qe vijne nga ky sektor.

Sektori i transporti ne Shqiperi vazhdon ritmin e ritjes ne masen 2% duke patur nje peshe me te larte ne konsumin e lendeve energjetike ne masen 43 %. Ndikim ne kete zhvillim ka permiresimi i infrastruktures rrugore e cila ka rritur numrin e automjeteve, duke rritur ngarkesen totale te trafikut nga viti ne vit. Per vitin 2017 numri i automjeteve arriti 535570 mjete me nje ulje prej 3% krahasuar me vitin 2016. Per vitin 2017 konsumi i ketij sektori ne te gjitha aktivitetet e tij eshte 828 ktoe ndersa ne vitin 2016 ishte 826 ktoe, ku pjesen dermuese te konsumit vazhdon ta kete transporti rrugor ne kontrast me transportin hekurudhor dhe transportin ujor.

### **5.3 Sektori i banesave**

Konsumi i energjise ne sektorin e banesave perfshin nje mori sherbimesh energjetike perfshire ngrohjen e hapësirave, kondicionimin e ajrit, ujin e ngrohje, gatimin, ndricimin dhe pajisjet elektroshtepiake. Nga analiza e te dhenave te bilancit energjetik vazhdon konsumi drejt perdorimit te energjise elektrike per ngrohjen e hapësirave krahasuar me lendet e tjera energjetike si drute e zjarrit dhe LPG.

Kerkesa per energji nga sektori i ndertesave perben nje sfide te madhe per vendin tone pasi ky sektor konsumon 60% te konsumit kombetar te energjise elektrike. Vlen te theksoje se ne zonat rurale vazhdon konsumi i druve te zjarrit per ngrohje dhe gatim.

Sektori i banesave ze vendin e dyte ne sasine e konsumit final te energjise ne Shqiperi, pas transportit me nje peshe specifike prej 26 %. Per vitin 2017 ne kete sektor shihen tendenca per nje konsum eficient te energjise si pasoje e kontrollit te energjise elektrike e cila ka peshen kryesore te lendeve djegese energjitike. Per vitin 2017 konsumi i energjise ne kete sektor eshte 484 ktoe ndersa per vitin 2016 ishte 498 ktoe pra me nje ulje prej 3%.

### **5.4 Sektori i sherbimeve**

Sektori i sherbimeve ndahet ne dy nensektore: sherbimet publike dhe sherbimet private. Ky sektor ne vleresimet tona eshte kategorizuar se bashku me sektorin publik dhe aktivitetin tregtar jo-industrial (qe njihet gjithashtu si “sektori terciar”). Tradicionalisht, sektori i sherbimeve publike per te siguruar ngrohjen, mbeshtetet te konsumi i energjise elektrike dhe i druve te zjarrit.

Ne analizen e bilancit energjetik te vitit 2017 u vleresuan 6.9 milione m<sup>2</sup> siperfaqe e pergjitheshme grupit te llojeve kryesore te ndertesave publike, shifer qe nuk pritet te ndryshoje ne menyre te konsiderueshme.

Ashtu si ne sektorin e banesave, perqindja e konsumit final te energjise ne sektorin e sherbimeve ka mbetur e qendrueshme, duke zene 9% te te gjithe konsumit final te energjise. Kjo eshte ne kontrast me pritshmerite e zhvillimit te ketij sektori, qe parashikon nje rritje me te shpejte por eshte diktuar nga zhvillimi ekonomik i vendit tone.

Ne terma absolute, konsumi i energjise ne kete sektor ishte 8% me i larte se ne vitin 2016 , me nje vlere prej 204.5 ktoe.

### **5.5 Sektori i bujqesise**

Bujqesia eshte nje nga sektoret kryesore te ekonomise ne Shqiperi, qe kontribuon me rreth 20% te vleres se shtuar ne ekonomi. Gjate dekades se fundit, pavaresisht nje sere problemesh strukturore, sektori ka patur nje rritje te moderuar. Zgjerimi i sektorit, gjate periudhes 1999-2017, mendohet te kete kontribuar ne performancen e pergjithshme te ekonomise ne vend. Pervec kesaj, rritja e

cmimeve te produkteve bujqesore ne tregjet boterore percjell stimujt e duhur per rritjen afatgjate te prodhimit te kesaj dege te ekonomise shqiptare. Per me teper, zhvillimet dhe reformat strukture (qe synojne rritjen e eficiences ne prodhimin bujqesor, lehtesimin e aksesit te produkteve bujqesore ne tregun e brendshem dhe tregjet e huaja, si dhe mbeshtetjen financiare te bizneseve dhe fermave te ketij sektori) jane konsideruar si nje prioritet i politikave ekonomike te ardhshme.

Pare ne aspektin e konsumit te energjise sektori i buqesise ku futet edhe peshkimi ne bilalcin e konsumit te energjise per vitin 2017 ze nje peshe 3.6 %. Pare ne kontributin e ketij sektori ne ekonomine shqiptare ky sektor vazhdon te ece me ritme te ngadalte ne modernizimin e tij. Per vitin 2017 konsumi i ketij sektori ishte ne vleren 112.56 ktoe.



## ANEKS Bilanci Energjetik 2017

Year 2017		TOTAL	Solid fuels	Natural Gas	Crude, NGL and Feedstock	Biomass (Fuelwood)	Hydro & Electricity	Solar Energy	Derived Heat
Primary production		1660.55	45.80	81.6	958.94	168	389.15	13.20	3.9
Recovered products		0.00			0.0				
Imports (Pet Prod+ Electricity)		1568.67	74.80		1229.27	13.940	250.66		
Stock change		177.34			177.34				
Exports		649.61	20.90		611.48	17.230	0.00		
Bunkers		36.00			36.00				
<b>Gross inland consumption</b>		<b>2366.28</b>	<b>99.70</b>	<b>81.6</b>	<b>1363.39</b>	<b>164.71</b>	<b>639.81</b>	<b>13.20</b>	<b>3.88</b>
<b>Transformation input</b>		<b>922.33</b>			<b>533.18</b>		<b>389.15</b>		
Classic thermal Power Stations		0.00			0		0		
Public Hydro power stations		389.15					389.15		
Autoprod. thermal power stations		0.00			0.00		0		
Nuclear power stations		0.00							
Patent fuel and briquetting plants		0.00							
Coke-oven plants		0.00							
Blast-furnace plants		0.00							
Gas works		0.00							
Refineries		533.18			533.18				
District heating plants		0.00							
<b>Transformation output</b>		<b>839.66</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>503.01</b>	<b>0</b>	<b>335.15</b>	<b>0.00</b>	<b>1.5</b>
Classic thermal Power Stations		0.00					0.00		
Public Hydro power stations		386.71					386.71		
Autoprod. thermal power stations		0.00							
Nuclear power stations		0.00							
Patent fuel and briquetting plants		0.00							
Coke-oven plants		0.00							
Blast-furnace plants		0.00							
Gas works		0.00							
Refineries		504.51			503.01				1.5
District heating plants		0.00	0						
<b>Exchanges and transfers, returns</b>		<b>0.00</b>							
Interproduct transfers		0.00							
Products transferred		0.00							
Returns from petrochem. industry		0.00							
<b>Transformation Losses</b>		<b>8.85</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6.21</b>	<b>0</b>	<b>2.44</b>	<b>0.00</b>	<b>0.2</b>
<b>Consumption of the energy branch</b>		<b>155.60</b>	<b>0</b>	<b>81.6</b>	<b>58.64</b>	<b>0</b>	<b>15.37</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Production and distribution of electricity		4.10					4.10		
Pumped storage stations		0.00							
District heating plants		0.00							
Extraction and aggro. of solid fuels		2.34					2.34		
Coke-oven and gas works plants		0.00							
Oil and Nat. Gat extraction plants		34.42		27.7	2.20		4.52		
Oil & Gas pipelines		0.00			0				
Oil refineries		60.85		0.0	56.44		4.41		
Nuclear fuel fabrication plants		0.00							
<b>Distribution losses (humbje jo tekn ne shpernd)</b>		<b>107.30</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>107.30</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
<b>Available for final consumption</b>		<b>2147.12</b>	<b>99.70</b>	<b>53.9</b>	<b>1298.54</b>	<b>164.71</b>	<b>514.70</b>	<b>13.20</b>	<b>2.38</b>
<b>Final non-energy consumption</b>		<b>77.39</b>		<b>40</b>	<b>37.39</b>				
Chemical industry		0.38			0.38				
Other sectors		77.01		40	37.01				
<b>Final energy consumption</b>		<b>2069.73</b>	<b>99.7</b>	<b>13.9</b>	<b>1261.1</b>	<b>164.71</b>	<b>514.70</b>	<b>13.2</b>	<b>2.4</b>
Industry		413.40	96.00	10.2	189.17	7	107.93	0.72	2.4
Iron & steel industry		20.51			5.21		15.30		
Non-ferrous metal industry		4.24			0.00		4.24		
Chemical industry		15.28			7.51		7.77		
Glass, pottery & building mat. industry		242.99	86.20		138.25		18.54		
Ore-extraction industry		16.88			0.31		16.57		
Food, drink & tobacco industry		50.56		7.2	20.47		19.79	0.72	2.4
Textile, leather & clothing industry		14.51			2.17		12.34		
Paper and printing		8.29			1.41		6.88		
Engineering & other metal industry		3.55			1.32		2.24		
Other industries		37.09	9.8	3.00	12.53	7	4.36		0.40
<b>Transport</b>		<b>828.17</b>	<b>0</b>	<b>0.00</b>	<b>828.17</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0</b>
Railways		2.10			2.10				
Road transport		783.88			783.88				
Air transport		7.28			7.28				
Inland navigation		34.91			34.91				
Households, commerce, pub. au		689.42	3.7	0.00	149.87	145.7	377.66	12.48	0.00
Households		484.87	0		95.00	130	252.37	7.50	
Agriculture		74.06			55.44	12	6.62		
Fisheries		38.50			38.50				
Other		22.49			0.00		22.49		
<b>Statistical difference</b>					<b>0.00</b>			<b>0</b>	<b>0</b>

Refinery gas	LPG	Motor spirit	Kerosenes, jet fuels	Naphtha	Gas / diesel oil	Residual fuel oil	Other pet. products	Gasoline	Lubrificants	Bitumen	Petroleum Coke	White spirit
19.30	0.00	0.00	0.00	40.02	158.25	0.00	102.86	0.00	0.00	77.10	105.47	0.00
0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
0.00	252.30	0.00	17.28	0.00	722.53	0.04	4.41	147.98	7.28	2.11	74.96	0.38
0.00	90.00	0.00	10.00	7.08	15.63	0.00	2.00	42.00	0.00	10.00	0.62	0.00
0.00	0.00	0.00	0.00	32.95	19.03	0.00	18.43	0.00	0.00	50.74	34.42	0.00
0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	36.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
19.30	162.30	0.00	7.28	0.00	810.12	0.04	86.85	105.98	7.28	18.47	145.39	0.38
							0					
19.30	0.00	0.00	0.00	40.02	158.25	0.00	102.86	0.00	0.00	77.10	105.47	0.00
19.30	0.00	0.00	0.00	40.02	158.25	0.00	102.86	0.00	0.00	77.10	105.47	0.00
							2.55			3.66		
19.30	2.2	0	0	0	0	0.04242	37.10	0	0	0	0	0
												0
	2.2											
19.30	0				0	0.04	37.1					
0.00	160.10	0.00	7.28	0.00	810.12	0.00	47.20	105.98	7.28	14.81	145.39	0.38
0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	22.20	0.00	0.00	14.81	0.00	0.38
				0.00						0		0.38
0.00	160.10	0.00	7.28	0.00	810.12	0.00	25.00	105.98	7.28	0.00	145.39	0.00
0	7.90	0	0	0.00	7.20		15.70	5.7	7.28	0.00	145.39	0
					0.88		0.00					4.33
					0.00		0.00					0.00
	1.34				0.87		0.61	4				0.68
					1.95		0.27					136.03
					0.31		0.00					0.00
	3.87				0.61		12.23					3.75
					0.98		1.19					0.00
					0.88		0.53					0.00
					0.72		0.00					0.60
	2.69				0.00		0.86	1.7	7.28	0.00		0.00
	6.23		7.28		718.58		0.00	96.08				
					2.10							
	6.23				686.45			91.20				
			7.28									
					30.03		0	4.88				
	142.37						7.50	0				
	95.00						0.00	0				
	3.6				50.04		1.80					
					34.30			4.20				
0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00